



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajvali - Prishtinë

Nr. / Br. 04-052-1650/6

Data / Datum 18.12.2017



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**

**RAPORT
I INSPEKTIMIT MBI MENAXHIMIN E HETIMIT DHE ZBULIMIT TË
KRIMIT, SI DHE ADMINISTRIMIT TË RASTEVE**

Nr. 4/2017

Prishtinë, 14 dhjetor 2017

Informata të përgjithshme

Titulli	Raport i inspektimit mbi menaxhimin e hetimit dhe zbulimit të krimit, si dhe administrimit të rasteve
Data e përgatitjes	14 dhjetor 2017
Përgatitur nga	Fitore Gajraku, inspektor, Kushtrim Jonuzi, inspektor
Mbikëqyrur nga	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	Bujar Mustafa Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	Bekim Pira Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	Hilmi Mehmeti Kryeshef Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
Data e miratimit	14 dhjetor 2017





**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**



**RAPORT
I INSPEKTIMIT MBI MENAXHIMIN E HETIMIT DHE ZBULIMIT TË
KRIMIT, SI DHE ADMINISTRIMIT TË RASTEVE**

Nr. 4/2017

Prishtinë, 14 dhjetor 2017

Informata të përgjithshme

Titulli	Raport i inspektimit mbi menaxhimin e hetimit dhe zbulimit të krimit, si dhe administrimit të rasteve
Data e përgatitjes	14 dhjetor 2017
Përgatitur nga	Fitore Gajraku, inspektor, Kushtrim Jonuzi, inspektor
Mbikëqyrur nga	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	Bujar Mustafa Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	Bekim Pira Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	Hilmi Mehmeti Kryeshef Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
Data e miratimit	14 dhjetor 2017

1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)
- 1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....(5-5)

2. Hyrje

- 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)
- 2.2. Qëllimi.....(6-6)
- 2.3. Objekti.....(6-6)
- 2.4. Subjekti.....(6-6)
- 2.5. Objektivat e inspektimit.....(6-7)
- 2.6. Rëndësia e inspektimit.....(7-7)
- 2.7. Metodologjia e inspektimit.....(7-8)
- 2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit.....(8-8)
- 2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit.....(8-8)
- 2.10. Drejtimit e inspektimit.....(8-8)
- 2.11. Kriteret e vlerësimit.....(8-9)
- 2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(9-9)

3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1. Organizimi, funksionimi dhe kapacitetet policore në hetimin e krimit.....(10-13)
- 3.2. Procedura e hetimit dhe dokumentimit të aktivitetit kriminal.....(13-16)
- 3.3. Indikatorët e performancës në hetimin dhe zbulimin e krimit.....(16-20)
- 3.4. Raportimi i rasteve dhe menaxhimi i vendit të ngjarjes.....(20-20)
- 3.5. Evidentimi, trajtimi dhe ruajtja e dëshmive.....(21-22)
- 3.6. Administrimi i dosjeve kriminale.....(22-24)

4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(25-26)

Shtojcat

1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Policia e Kosovës (PK) është një agjenci e re e zbatimit të ligjit, që ka kaluar në disa faza të zhvillimit të saj. Nga paslufta, organizimi i brendshëm i saj është ndikuar nga politikat dhe përvojat e vendeve që kanë mbështetur aktivitetin dhe zhvillimin e saj. Deri më sot janë funksionalizuar një mori strukturash të organizimit, kurse kjo e fundit konsiderohet si një strukturë që merr parasysh kërkesat, nevojat dhe që ofron ndarje të detyrave dhe vijave të komunikimit dhe raportimit. Lidhur me organizimin e brendshëm strukturor të Departamentit të Hetimit, të strukturuar në një numër divizionesh dhe drejtorish operative dhe mbështetëse, vlerësohet se struktura aktuale mundëson një ndarje detyrash dhe ndërmarrje veprimesh operative drejt parandalimit dhe luftimit efikas të krimit. Aktivitetet operative policore mbështeten në një bazë të gjerë ligjesh dhe aktesh nënligjore. Kodi Penal i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe Ligji për Policinë paraqesin shtyllat kryesore që rregullojnë punën hetimore të Policisë. Meqenëse, infrastruktura ligjore në të cilën bazohet puna policore i nënshtrohet ndryshimeve dhe plotësimeve permanente, është vërejtur se nuk është punuar sa duhet në harmonizimin e procedurave standarde operuese me dokumentet bazike ligjore. Nuk është arritur ende të stabilizohet struktura e personelit në Departamentin e Hetimit, meqë edhe më tej ka probleme me sistemimin e personelit të graduar dhe plotësimin e vendeve të punës dhe pozitave sipas Listës së Autorizuar të Personelit (LAP). Departamenti i Hetimit konsiderohet se ka kapacitetet e mjaftueshme profesionale për t'iu kundërvënë nivelit të krimit, meqë personeli hetues është i përgatitur, falë programeve bazike dhe të avancuara trajnuese. Në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit, PK-ja ka nevojë për teknikë të avancuar hetimore për të ndjekur trendet e arritjeve teknologjike. Lidhur me evidencat e krimit në vend dhe përfshirjes në veprimtari kriminale të individëve dhe grupeve kriminale, ka nevojë për një ngritje të nivelit të bashkëpunimit të trekëndëshit Polici- Prokurori- Gjykatë, në fushën e kthimit të informatave lidhur me rezultatet e rasteve të iniciuara penale.

1.1.2. Lidhur me vlerësimin e rregullësisë së lëndëve me dokumentet dhe formularët e nevojshëm që kanë të bëjnë me hetimin dhe dokumentimin e krimit, është vlerësuar se një numër dosjesh hetimore nuk kanë pasur Raportin policor njoftues për Prokurorin, bazuar në nenin 70 të KPPK-së. Bazuar në dokumente mbi kompetencën lëndore, vlerësohet se lëndët e inspektuara janë të ndara në fushën e hetimit të cilit i takojnë, konform dispozitave ligjore mbi kompetencën lëndore. Ato janë në kompetencën lëndore të drejtorive hetimore, analizuar nga modusi i kryerjes së veprës penale dhe specifikat tjera të secilit rast penal. Format e përdorura brenda dosjeve nuk janë unike në kuadër të drejtorive dhe nuk ka një standard të njëjtë të hartimit të shkresave në këto drejtori. Në disa dosje janë gjetur deklaratat që nuk i përmbajnë të drejtat e rezervuara të të dyshuarve, gjegjësisht të dëshmitarëve. Në disa prej tyre që i përmbajnë të drejtat e të intervistuarve, ato të drejta nuk janë konform KPPK-së. Ka deklaratat të pa nënshkruara nga marrësit e deklaratave dhe personat e dyshuar apo dëshmitarët e intervistuar. Dosjet hetimore që kanë të bëjnë me persona të arrestuar, kanë qenë të pajisura me aktvendime mbi ndalimin e personit të arrestuar. Kallëzimet penale të ngritura nga hetuesit janë përgatitur kënaqshëm në aspektin teknik, ngase përmbajnë elemente të nevojshme përmbajtësore për t'u dorëzuar në Prokurorinë kompetente. IPK-ja çmon respektimin e dispozitave ligjore të përcaktuara në KPPK lidhur me deklaratat e të dyshuarve për rastet ku prezenca e avokatit ka qenë e domosdoshme gjatë marrjes së deklaratës.

1.1.3. Policia është përfshirë si akter me rëndësi në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe këtë e dëshmon përfshirja e saj në një numër strategjish kombëtare të luftës kundër krimit. Objektivat e këtyre strategjive janë adresuar edhe në Planin Zhvillimor Strategjik dhe Planin e Veprimit të PK-së. Në kuadër të Departamentit është nxjerrë edhe Plani Vjetor i Departamentit dhe ato të drejtorive hetimore, plane këto që vlerësohet se adresojnë hapat e nevojshëm drejt parandalimit dhe luftimit të krimit. Raportet policore pasqyrojnë ngritje të aktivitetit hetimor, krahas ngritjes edhe të nivelit të krimit. Indikatorët e performancës pasqyrojnë trende pozitive të luftimit të krimit. Ka shënuar ngritje numri i kallëzimeve të ushtruara në Prokurori, numri i të arrestuarve, numri i operacioneve, numri i bastisjeve dhe lokaleve të kontrolluar. DHKEK dhe DHTN mbeten drejtoritë me numrin më të madh të rasteve, me të cilat janë ngarkuar në dy vitet e fundit. Bashkëpunimi me Prokurorinë mbetet prioritar. Bashkëpunimi është shtrirë në drejtimin ndër-institucional, ndërkombëtar dhe me EULEX-in. Roli i DIA-së mbetet i një rëndësie të veçantë në grumbullimin, trajtimin, analizimin dhe shpërndarjen e informatave inteligjente në drejtoritë hetimore. Nevojitet mobilizim i shtuar në ofrimin e më shumë informatave kthyesë tek DIA, nga drejtoritë hetimore. Kthimi i informatave shpie në vlerësimin më të drejtë të burimeve të tyre. Disa nga dosjet që kanë pasur materie e që është lidhur edhe me menaxhimin e vendngjarjes dhe administrimit të dëshmive, vlerësohet se veprimet e ndërmarra nga ekipet e teknikës kriminalistike janë zhvilluar konform dispozitave që parashihen me PSO.

1.1.4. Lidhur me fushën e trajtimit të dëshmive, është e rregulluar me procedurë të veçantë ruajtja, evidentimi dhe trajtimi i tyre. Rezultatet e inspektimit janë inkurajuese në shumë pika, por mbetet të trajtohet tutje vendosja dhe paketimii i dëshmive, varësisht prej specifikave të tyre (brisqet e rrojës dhe shiringat nuk trajtohen dhe nuk ruhen në kontejner të veçantë përshkak të mungesës së kontejnerëve për ruajtjen e tyre). Gjatë një verifikimi të kryer në Dhomën Qendrore të Dëshmive, sendet dhe dëshmitë që janë lidhur me dosjet e përzgjedhura janë identifikuar lehtë dhe kanë qenë të paketuara dhe të shënuara në mënyrën e duhur konform standardeve. Lidhur me evidencat apo regjistrat, vërehet se mbahet Libri i dëshmive dhe evidenca elektronike. Kushtet fizike brenda Dhomës Qendrore konsiderohen të jenë konform standardeve. Gjendjen e shkëlqyeshme fizike dhe teknike të Dhomës e hendikepon mungesa e solucionit për larjen urgjente të syve.

1.1.5. Dosjet ruhen në hapësira të ndara në kuadër të secilës drejtori hetimore. Synohet që dosjet të mbahen në pronësi të drejtorive (fondkrijuesit) deri në dy (2) vite, me kusht që pas kësaj periudhe kur konsiderohen të 'përfunduara', të dorëzohen në Arkivin Qendror për ruajtje sipas afateve të ruajtjes. Edhe pse IPK-ja ka parasysh rregullat në fuqi deri në dorëzimin e tyre në Arkiv Qendror, drejtoritë hetimore të ngarkuara me dosjet penale duhet kuptuar rëndësinë e trajtimit të duhur të tyre, që nënkupton se kushtet në të cilat ato mbahen në dhoma të adaptuara, nuk janë të kënaqshme. Duke u referuar në Rregulloren mbi administrimin e dokumentacionit zyrtar, duhet ndërmarrë hapa të nevojshëm për administrimin e duhur të tyre, duke u krijuar kushte teknike, në mënyrë që të mbrohen nga dëmtimet dhe humbjet, deri në dorëzimin e tyre në Arkivin Qendror.

1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

1.2.1. Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga dhjetë (10) rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar (menaxhimi i hetimit dhe zbulimit të krimit, si dhe administrimit të rasteve, nr. 05/2015), gjashtë (6) prej tyre janë përmbushur pjesërisht, tre (3) nuk janë përmbushur fare, ndërsa një (1) rekomandim nuk është vlerësuar në këtë fazë inspektuese. *Për më tepër referoju shtojcës 1.*

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Policinë e Kosovës (PK), për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar një shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit të IPK-së, për vitin 2017 ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha të menaxhimit, përfshirë edhe menaxhimin e hetimit dhe zbulimit të krimit. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet fushë me interes për IPK-në, me qëllim të vlerësimit se PK-ja ka ndërtuar strukturë organizative funksionale me kapacitete të mjaftueshme teknike e njerëzore për hetimin dhe zbulimin e krimit, se ka nxjerrë dhe zbatuar bazën ligjore dhe strategjike të nevojshme për të ulur trendet e krimit, si dhe është përfshirë seriozisht dhe me përkushtim në përmbushjen e objektivave në forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit në vend. Andaj, është e nevojshme që profesionalizmi, përkushtimi dhe llogaridhënia të jenë evidente dhe të qëndrueshme në menaxhimin sa më efektiv të rasteve penale.

2.2. Qëllimi

2.2.1. Qëllimi i inspektimit është:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat përkatëse zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet,
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat,
- Që të jepet një opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me këtë fushë të menaxhimit,
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së PK-së në fushën përkatëse,
- Të identifikojë mangësitë apo dobësitë dhe të rekomandojë masa ligjore dhe organizative për funksionimin më të mirë të PK-së.

2.3. Objekti

2.3.1. Në këtë inspektim është vlerësuar kryerja e detyrave policore në fushën e menaxhimit të hetimit dhe zbulimit të krimit, si dhe administrimit të rasteve.

2.4. Subjekti

2.4.1. Inspektimi është përqendruar në nivel qendror, kryesisht në Departamentin e Hetimit, divizionet dhe drejtoritë përkatëse të hetimit dhe zbulimit të krimit.

2.5. Objektivat e inspektimit

2.5.1. Objektivat që ka synuar t'i arrijë ky inspektim janë:

- Të vlerësohen kapacitetet ligjore, organizative, profesionale dhe teknike në hetimin e krimit,
- Të vlerësohet respektimi i rregullave dhe procedurave në hetimin dhe zbulimin e krimit,
- Të analizohen dhe krahasohen indikatorët që paraqesin relevancë në luftimin efikas të krimit

- Të vlerësohet mënyra e raportimit të rasteve dhe menaxhimit të vend-ngjarjes,
- Të vlerësohet respektimi i procedurave/rregullave në evidentimin dhe trajtimin e dëshmive,
- Të vlerësohet mënyra e administrimit të dosjeve penale.

2.6. Rëndësia e inspektimit

2.6.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ngritjen e profesionalizmit dhe përkushtimit të personelit hetimor, për të siguruar shkallë më të lartë të efikasitetit në hetimin dhe zbulimin e veprave penale,
- Ngritjen e përgjegjësisë së personelit hetimor në respektimin e rregullave dhe procedurave për hetimin e krimit,
- Ngritjen e vetëdijes policore për të zhvilluar qasje aktive në parandalimin dhe zvogëlimin e rasteve kriminale,
- Ngritjen e përgjegjësisë dhe ruajtjen e integritetit gjatë hetimit të veprave penale të supozuara dhe përdorimit të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit,
- Ngritjen e besimit të qytetarëve te autoritetet hetimore mbi menaxhimin e hetimit, zbulimit dhe dokumentimit të rasteve penale,
- Sigurimin e një qasjeje parimore të personelit hetimor në respektimin e të drejtave dhe lirive të viktimave dhe personave të dyshuar.

2.7. Metodologjia e inspektimit

2.7.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar intervista dhe takime me punonjës policorë, si në vijim:
 - Drejtorin e Departamentit të Hetimit,
 - Drejtorin e Divizionit Kundër Krimit të Organizuar (DKKO),
 - Drejtorin e Divizionit për Hetimin e Krimit (DHK),
 - Drejtorin e Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar (DHKO),
 - Drejtorin e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë (DHTN),
 - Drejtorin e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (DHTQNJ),
 - Drejtorin e Drejtorisë për Mbështetje të Hetimeve (DMH),
 - Drejtorin e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Rënda (DHKR),
 - Drejtorin e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK),
 - Drejtorin e Drejtorisë Kundër Terrorizmit (DKT),
 - Drejtorin e Drejtorisë për Inteligjencë dhe Analiza (DIA),
 - Drejtorin e Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike (DTK),
 - Zyrtarin e Dhomës së dëshmive,
 - Administratorët e dosjeve penale.
- b) Janë kryer vëzhgime, këqyrje apo kontrollime të dosjeve, si në vijim:
 - Inspektimi i kushteve të punës në hapësirat e punës së personelit hetimor,
 - Kontrollimi i administrimit të dosjeve penale dhe kushtet teknike në Arkivë,
 - Kontrollimi i administrimit të dëshmive dhe kushtet teknike në Dhomën e dëshmive.
- c) Janë plotësuar formularët e inspektimit të përgatitur nga Departamenti i Inspektimit:

- Lidhur me evidencat, regjistrat dhe kushtet brenda arkivave (dhomave) të dosjeve,
- Lidhur me evidencat, regjistrat, trajtimin dhe kushtet brenda Dhomës së dëshmimeve.

d) Janë siguruar dëshmitë, si në vijim:

- Kopje të dosjeve hetimore,
- Raportet vjetore të punës,
- Planet vjetore të punës,
- Dëshmi mbi përgatitjen profesionale të personelit hetimor,
- Baza ligjore që rregullon aktivitetet dhe detyrat në se cilën drejtori, divizion apo sektor në kuadër të Departamentit,
- Skema e organizimit të Departamentit, përfshirë drejtorinë, divizionet dhe sektorët,
- Lista e Autorizuar e Personelit dhe ajo aktuale,
- Lista e pajisjeve dhe mjeteve tjera të punës,
- Dokumente tjera që kanë ndihmuar vlerësimin e pikave të përcaktuara me Program.

2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit

2.8.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 08.08.2017 dhe ka përfunduar më datë 18.08.2017.

2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit

2.9.1. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave policore gjatë periudhave kalendarike janar-dhjetor 2015 dhe janar-dhjetor 2016. Veç tjerash, inspektimi është fokusuar edhe në gjendjen aktuale, siç është rasti i inspektimit të kushteve brenda Dhomës së dëshmimeve dhe Arkivës së dosjeve.

2.10. Drejtimet e inspektimit

2.10.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është përqendruar në këto drejtime kryesore:

- Organizimi, funksionimi dhe kapacitetet policore në hetimin e krimit,
- Procedura e hetimit dhe dokumentimit të aktivitetit kriminal,
- Indikatorët e performancës në hetimin dhe zbulimin e krimit,
- Raportimi i rasteve dhe menaxhimi i vendit të ngjarjes,
- Evidentimi, trajtimi dhe ruajtja e dëshmimeve,
- Administrimi i dosjeve kriminale.

2.11. Kriteret e vlerësimit

2.11.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave në departament, divizione, drejtori dhe sektorë hetimorë:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës,
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës,
- Ligji i Policisë,
- Doracakut i Parimeve dhe Procedurave,

- Procedura Standarde e Operimit për procedimin e lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit (ZDPO/02/021/2013),
- Rregullorja nr 13/2015 për administrimin e dokumentacionit zyrtar,
- Procedura Standarde e Operimit për menaxhimin e dokumenteve arkivore (DSHB-1.05),
- Procedura Standarde e Operimit për Dhomën e dëshmime (ZDPO-02/008/14),
- Strategjitë Nacionale dhe ato të PK-së për luftimin e krimit,
- Udhëzuesi për përmbajtjen dhe radhitjen e dosjes penale, dhe
- Dokumentet tjera relevante që rregullojnë fushën e hetimeve.

2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave

2.12.1. Gjatë inspektimit është shfaqur një hezitim tek drejtuesit e disa drejtorive hetimore rreth dorëzimit të dosjeve hetimore që janë konsideruar si dosje të mbyllura. Falë mirëkuptimit dhe gatishmërisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për të ofruar bashkëpunim të ngushtë me IPK-në, është lejuar qasje e pakufizuar dhe inspektorët kanë siguruar informacionet e nevojshme, duke u kujdesur që informatat e disponueshme të trajtohen në mënyrën e duhur. Kjo çështje ka bërë që edhe afatet për raportimin e gjetjeve, të prolongohen për disa javë.

3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Organizimi, funksionimi dhe kapacitetet policore në hetimin krimin

3.1.1. Në shoqëritë e organizuara, Policisë i takon vend i posaçëm në luftën kundër kriminalitetit. Shteti duhet të ndërmarrë hapa të nevojshëm për të siguruar që të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të jenë të garantuara. Institucionet shtetërore kanë një rol të rëndësishëm për të kontribuar në ngritjen e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke bërë që çdo individ të jetë subjekt vetëm i atyre kufizimeve që janë në pajtim dhe në fuqi me ligjet përkatëse për të drejtat e njeriut në shoqëritë demokratike. Në këtë drejtim, detyrë kryesore e PK-së është parandalimi, hetimi dhe zbulimi i krimit, mbrojtja e jetës, pronës dhe ofrimi i sigurisë për të gjithë qytetarët si dhe detyra të tjera të parapara me ligj. Veprimet hetimore dhe masat e nevojshme në kuadër të hetimit, zbulimit dhe dokumentimit të krimit duhet të jenë të mbështetura dhe në harmoni me aktet ligjore në fuqi. Për kundërvënie me sukses ndaj kriminalitetit, Policia është e mandatar që të ndërmarr aktivitete policore dhe të bëjë planifikimet e duhura objektive, duke përfshirë edhe strukturimin e brendshëm organizativ dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore në mënyrë të drejtë, bazuar në kriteret mbi planifikimin dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore. Bazë e funksionimit efikas të Policisë është organizimi i duhur strukturor dhe shpërndarja e personelit. Aktivitetin e saj hetimor, PK-ja e ka të shtrirë në nivel qendror dhe atë lokal. Në nivel qendror, PK-ja kryesisht punën hetimore e fokuson në Departamentin e Hetimeve, i cili ka qenë edhe subjekt i këtij inspektimi. Departamenti për Hetime është i ndarë në dy (2) divizione për hetimin e krimit: Divizioni për Hetimin e Krimeve dhe Divizioni Kundër Krimit të Organizuar. Në kuadër të divizioneve janë strukturuar nëntë (9) drejtori operative dhe mbështetëse. Drejtoritë kanë sektorë të shpërndarë në nivel lokal dhe operojnë në drejtoritë rajonale policore, por që për punët e tyre u përgjigjen drejtorive të cilave u takojnë.

3.1.2. Për të zhvilluar aktivitete në zbulimin dhe hetimin e krimit, Policia ka një bazë ligjore mjaft të pasur mbi të cilën mbështeten veprimet hetimore të zyrtarëve hetues. Kodi Penal i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe Ligji për Policinë janë ligjet kryesore që përcaktojnë dhe rregullojnë punën hetimore të Policisë. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) ka përcaktuar veprimet e Policisë në hetimin dhe zbulimin e krimit. Veprimet hetimore janë rregulluar edhe me akte tjera të brendshme që hollësisht përcaktojnë rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë me fushat e caktuara dhe mënyrën se si të implementohen dispozitat ligjore (udhëzimet, rregulloret, procedurat standarde të veprimit). Është analizuar infrastruktura ligjore me të cilën shërbehen hetuesit e drejtorive në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të tyre. Të gjeturat tregojnë gjendje jo të kënaqshme lidhur me harmonizimin e akteve më të ulëta ligjore, siç është rasti me procedurat standarde të operimit, ku është gjetur se shtatë (7) PSO nuk janë të harmonizuara me aktet më të larta ligjore¹. Me qëllim të unifikimit të akteve që kanë të bëjnë me punën operative, IPK-ja në vazhdimësi ka rekomanduar që të bëhet azhurnimi i akteve më të ulëta ligjore me ato më të larta, në rastet kur ligjet themelore pësojnë ndryshime. Në Planin e Veprimit për Parandalimin e Krimit (2013-2017), Policia si aktor kyç në luftimin e krimit në

¹ (DTK-PK/SHH-PSO 1.21, datë 12.04.2012; DTK-PK/SHH-PSO 1.18, datë 12.10.2011; DMH-PK/SHH-PSO 1.25, datë 12.04.2012; DIA-PK/SHH-PSO 1.10, datë 28.06.2011; DHTN-PK/SHH-PSO 1.20, datë 02.12.2011; DKT-PK/SHH-PSO 1.09, datë 12.04.2011; DHTQNJ-PK/SHH-PSO 1.22, datë 12.04.2012; DHKEK-PK/SHH-PSO 1.08, datë 12.04.2011)

bashkëpunim me akterët tjerë² ka paraparë rishikimin e harmonizimin e kornizës ligjore, plotësim-ndryshimin dhe harmonizimin e legjislacionit në fushën e parandalimit të krimit. Në bazë të këtij Plani, PK-ja obligohet të hartojë dhe miratojë akte nënligjore (PSO) për plotësimin e rregullativës ligjore në fushën e parandalimit të krimit. Kjo ngritë përgjegjësinë dhe efikasitetin e hetuesve në kryerjen e punëve hetimore.

Rekomandimi nr. 1

IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit të Hetimeve që të rishikojë dhe plotësojë të gjitha PSO-të, të cilat nuk janë të azhurnuara me aktet më të larta ligjore, me qëllim të ngritjes së përgjegjësisë në mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e zyrtarëve policorë.

3.1.3. Organizimi policor herë pas here i është nënshtruar proceseve të ndryshimeve strukturale, që janë përcjellë edhe me procese të gradimit, me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe plotësimin të strukturës së aprovuar me gradat e duhura. Nëse u referohemi numrave mbi shtrirjen e kontrollit menaxherial, Departamenti i Hetimeve ende nuk ka arritur të stabilizojë numrin e të graduarve dhe zyrtarëve sipas Listës së Autorizuar të Personelit. Sa i përket numrit të përgjithshëm të të angazhuarve në Departament, vërehet se ende nuk kemi numër të balancuar të kapaciteteve të angazhuara në raport me numrin e përcaktuar me Listë. Në drejtoritë qendrore të hetimit të krimit nuk është arritur të stabilizohet struktura e të punësuarve. Sa i përket shpërndarjes së burimeve sipas gradave, mbetet shumë për t'u punuar, ngase në shumë raste kemi mungesë të të graduarve për të përmbushur pozitat nëpër drejtori, derisa në anën tjetër kemi tejkalim të numrit të të graduarve në krahasim me atë që e përcakton Lista përbrenda drejtorive. Deri te kjo gjendje ka ardhur si rezultat që organizata policore është në zhvillim e sipër dhe brenda saj ndodhin lëvizje dinamike, që përcillen me mungesa, transfere, sisteme, etj. IPK-ja vlerëson se duhet mobilizuar në drejtim të sigurimit të numrit të përcaktuar të kuadrove me Listën e aprovuar të Personelit. Është e nevojshme edhe një ri-shpërndarje e burimeve aktuale sipas skemës së gradave që e parasheh po e njëjta Listë. Një ri-shpërndarje më adekuate e këtyre burimeve njerëzore ngritë efikasitetin dhe llogaridhënien në punë.

Rekomandimi nr. 2

IPK-ja i rekomandon Departamentit të Hetimeve që në bashkëpunim me Departamentin për Burime Njerëzore, që të plotësojë strukturën e personelit në drejtoritë e hetimeve në përputhje me Listën e Autorizuar të Personelit, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për punë efikase në luftën kundër kriminalitetit dhe zbardhjes së rasteve penale.

3.1.4. Në ngritjen e efikasitetit dhe cilësisë së kryerjes së detyrave gjatë veprimtarisë hetimore, rol me rëndësi luan edhe niveli i përgatitjes profesionale të hetuesve. Kjo nënkupton se rëndësi të madhe ka edhe aftësimi profesional i zyrtarëve policore në fushën e hetimeve, i cili mund të arrihet përmes programeve të trajnimeve si burim kyç i njohurive dhe përgatitjes më të lartë në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore në luftimin kundër kriminalitetit. Për shkak të natyrës së veprave penale të cilat i hetojnë, hetuesit duhet të kenë trajnime dhe kualifikime adekuate në raport me

² Akterë tjerë janë konsideruar: Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF), Ministria e Drejtësisë (MD), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Doganat e Kosovës (DK), Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin Hetimor Penal (ICITAP), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

specifikat e veprave penale të cilat hetohen në nivelin qendror. Inspektimi ka vënë në pah se hetuesit në drejtoritë hetimore përgjithësisht kanë të kryer kurset bazike dhe të avancuara hetimore si dhe trajnime të tjera të avancuara. Është paraqitur nevoja që edhe më tutje të vazhdohet me zhvillim të trajnimeve profesionale në fushat përkatëse të drejtorive hetimore në rritjen e numrit të ekspertëve të certifikuar në kuadër të këtyre drejtorive, me qëllimin e arritjes sa më të lartë të njohurive profesionale krahas natyrës së veprave penale të cilat i hetojnë këto drejtori.

3.1.5. Aktivitetet kriminale në periudhën e tanishme janë shtuar dhe perfeksionuar shumë dhe grupet kriminale operojnë me metoda dhe mjete teknike shumë të sofistikuara, duke vështirësuar rënien në gjurmë të tyre. Diversiteti i veprimeve të grupeve kriminale dhe territori ku ato veprojnë, u ofron mundësi që në mënyrë më efektive t'i adaptohen situatave të ndryshueshme në një vend, gjersa i shfrytëzojnë dobësitë e sistemit hetimor për t'i kryer veprimet kriminale. PK-ja ka bërë përpjekjet e vazhdueshme që me mjetet dhe teknikat e avancuara të ngrisë kapacitetet teknike që të jetë në hap në zbulimin e metodave të kryerjes (modus operandi) së veprave penale. Bazuar në raportet vjetore të nxjerra nga drejtoritë qendrore të hetimit të krimit shihet se gjendja me mjete teknike të punës lenë hapësirë për t'u dëshiruar, me çka ndjehet nevoja e përmirësimit të këtyre kapaciteteve. Krijimi i kushteve për punë më cilësore dhe efikase dhe përmbushja e kriterëve mbi pajimin me pajisje teknike për të kryer veprimet ligjore, ndikon direkt në ngritjen e efikasitetit në luftën kundër dukurive kriminale. Në disa drejtori hetimore (DHTN, DKKO, DKT) ndihet nevoja për rritjen e kapaciteteve teknike me pajisje më të sofistikuara, të cilat mundësojnë përgjimet e rrjeteve të ndryshme të komunikimit, me qëllim të arritjes në kohë sa më të shkurtër të zbulimit të kryesve të krimit. Krijimi i një infrastrukture teknologjike dhe pajimi me pajisje të kësaj natyre do të ndikonte në lehtësimin e realizimit të objektivave të parapara në këto drejtori. Në intervistat e zhvilluara me drejtuesit e drejtorive hetimore dhe në raportet vjetore të punës, theksohet mungesa e dukshme e automjeteve dhe gjendja jo e mirë teknike për shkak të amortizimit të tyre fizik dhe teknologjik. Kjo paraqet sfida në realizimin e objektivave të planifikuara nga ana e drejtorive në drejtim të luftimit të krimit dhe ndikon direkt në efikasitetin operativ.

3.1.6. Sa i përket menaxhimit të të dhënave, përveç evidentimit fizik të tyre në librat e evidentimit të rasteve penale, PK-ja bën edhe evidentimin apo ruajtjen elektronike të të dhënave që dalin nga rastet penale në secilën drejtori. Ruajtja e të dhënave në mënyrë elektronike bëhet në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK), i normuar me PSO, me qëllim që të rregullojë dhe përcaktojë veprimet e zyrtarëve policorë për qasje në Sistem dhe të harmonizojë procedurat policore të evidentimit dhe shënimeve policore në fushat e përgjegjësisë konkrete lidhur me veprat penale të specifikuara sipas KPK-së. Kjo PSO përmban udhëzime për personelin mbi funksionimin e SIPK-ut dhe qëllimi kryesor është të sigurojë futjen me kohë dhe në mënyrë të saktë të të gjitha të dhënave kriminale, që të sigurojë informata reale dhe të sigurta për personelin në kuadër të këtij Sistemi. Është shikuar futja e të dhënave të rasteve hetimore në Sistem dhe është vërejtur se të gjitha subjektet e inspektuara kanë arritur që përkitazi me zhvillimin e rasteve penale, të vendosin edhe të dhënat. Drejtoritë hetimore kanë të rregulluar brenda tyre edhe bazën e të dhënave në formë kompjuterike, ku bëjnë ruajtjen e të dhënave për rastet penale për nevojat e brendshme. PK-ja ka infrastrukturë të qëndrueshme të mbajtjes së evidencave, që ndikon direkt në ngritjen e efikasitetit të funksioneve administrative të sistemit policor, mirëpo, gjatë komunikimit me zyrtarët policorë që menaxhojnë me SIPK, është vërejtur mungesa e komunikimit ndërmjet institucioneve zbatuese të ligjit (Gjykatë, Prokurori, Polici), për të marrë (kthyer) informacionin lidhur me vijueshmërinë

e rasteve të proceduara nga Policia. Një komunikim më i mirë do të sillte informata kthyesë nga këto institucione, që më pas do të vendoseshin në SIPK për të përmbushur evidentimin e të gjitha të dhënave që dalin nga vendimet e Prokurorisë dhe Gjykatës kompetente mbi statusin e rasteve dhe personave të dyshuar si kryerës të veprave penale. Bazuar në informata kthyesë, PK-ja do të mund të bëjë vlerësim më objektiv të performancës së zyrtarëve policorë bazuar në zbulueshmërinë e kryerësve të veprave penale. Inkurajojmë strukturën policore që në kuadër të bashkëpunimit me institucionet relevante, të ngritin çështjen e avansimit të nivelit të komunikimit të trekëndëshit Polici-Prokurori-Gjykatë, në mënyrë që rrjedha e ecurisë së rasteve dhe statusit të tyre gjatë fazave të procedurës penale, të jetë e azhurnuar në bazën e të dhënave të SIPK-ut.

Rekomandimi nr. 3

IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit të Hetimit, që në kuadër të bashkëpunimit me Prokurorinë dhe Gjykatat, të ngritë çështjen e mungesës së komunikimit të informatave, me qëllim që të dihet mbi statusin e rasteve gjatë fazave të procedurës penale dhe këto të dhëna të futen në bazën e të dhënave të Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK).

3.2. Procedura e hetimit dhe dokumentimit të aktivitetit kriminal

3.2.1. PK-së i takon vendi i posaçëm në luftën kundër krimit, prandaj për kundërvënie me sukses ndaj dukurive kriminale, ajo ndërmer aktivitete policore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Sipas KPPK-së, Policia pas pranimit të informatës për veprën penale të dyshuar, heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, të jetë kryer. Kompletimi i dosjes nga hetuesit, fillon nga momenti i marrjes së informatës, deri tek procedimi i rastit në organin kompetent. Janë siguruar një numër dosjesh hetimore nga secila drejtori hetimore. Janë kontrolluar dosje penale të proceduara në Prokurorinë kompetente me kallëzime penale apo raporte të veçanta, veprime këto të cilat janë burim kryesor i njohurive për veprën penale dhe kryesin, me të cilat njoftohet Prokurori i Shtetit. Për të bërë vlerësimin e rregullësisë së lëndëve me dokumentet dhe formularët e nevojshëm që kanë të bëjnë me hetimin e dokumentimin e krimit, janë kontrolluar 24 dosje të drejtorive, me ç'rast është bërë vlerësimi i respektimit të disa nga veprimet hetimore paraprake të Policisë si dhe vlerësimi i unifikimit të formave të përdorura brenda rasteve nga ana e hetuesve. Kriteret e përcaktuara për vlerësim janë mbështetur në KPPK dhe aktet të tjera ligjore, si pjesë e detyrave të zyrtarëve hetues që rrjedhin nga këto ligje pozitive.

3.2.2. Në kuadër të kriterëve të përcaktuara është bërë vlerësimi i prezencës së raportit policor brenda dosjes penale, i cili i drejtohet Prokurorit kompetent për njoftim mbi dyshimin e arsyeshëm se është kryer një vepër penale. Bazuar në dispozitën ligjore të KPPK-së, neni 70 paragrafi 4, 'posa policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, Policia është e detyruar që brenda 24 orëve t'i dorëzojë një raport policor, Prokurorit të Shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurë penale'. Tetë (8) nga 24 dosjet hetimore të kontrolluara, nuk kanë pasur Raportin policor njoftues për Prokurorin, bazuar në nenin 70 të KPPK-së (DHKEK, DKT, DHKO, DHTN, DHTQNJ)³. Në këtë mënyrë, zyrtarët policorë

³ IPK-ja nuk ka publikuar numrat e rasteve penale për shkak të ndjeshmërisë së tyre, me qëllim që të ruhet konfidenca mbi informatat dhe të mos ndikohet në zhvillimin e mëtejshëm të fazave të procedurës penale.

hetues në këto raste nuk e kanë përfillë nenin 70 të KPPK-së. Vlerësohet se mungesa e raportimit me shkrim në një pjesë të rasteve nga ana e zyrtarëve policorë për Prokurorin e Shtetit, i cili është kompetent, të paraparë në nenin 70 të KPPK-së, vjen nga neglizhenca e zyrtarëve policorë për të hartuar raporte me shkrim mbi përshkrimin e dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale për të cilën janë në dijeni. Në këto raste vërehet se raportimi i dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale është bërë praktikë e raportimit verbal nga ana zyrtarëve policorë tek Prokurori i Shtetit dhe kjo mënyrë e raportimit mund të krijojë situata të ndryshme të keqkuptimeve gjatë përshkrimit të rasteve në mes këtyre dy palëve.

Rekomandimi nr. 4

IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit të Hetimeve që të sigurohet që në rrethanat kur gjatë fazës paraprake të hetimeve vie deri tek 'dyshimi i arsyeshëm' se është kryer një veprë penale, brenda 24 orëve të respektohet dispozita ligjore nga KPPK-ja për t'i dorëzuar Prokurorit kompetent të Shtetit, raportin policor njoftues.

3.2.3. Ndarja e rasteve penale në drejtoritë kompetente bazohet në PSO-në (ZDPO/02/023/2013) e cila përcakton mënyrën e procedimit të lëndëve dhe kompetencën lëndore të hetimit, të aprovuar nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm për Operativë. Në përmbajtjen e saj rregullon mbarëvajtjen e procesit hetimor prej momentit të pranimit të informatës për shkelje ligjore-penale e deri tek kompletimi i rastit dhe procedimi i tij. Njëkohësisht në këtë PSO është paraparë edhe kompetenca lëndore për veprat penale sipas KPK-së. Veprat penale janë caktuar në kompetencë lëndore sipas natyrës dhe specifikave të veprave penale nga niveli lokal në nivelin qendror të hetimit të krimit. Të gjitha rastet e analizuara nga IPK-ja, janë të ndara në fushën e hetimit të cilit i takojnë konform dispozitave ligjore mbi kompetencën lëndore, të cilën e parasheh PSO-ja në fjalë. Të gjitha rastet e kontrolluara janë në kompetencën lëndore të drejtorive qendrore hetimore, analizuar nga modusi i kryerjes së veprës penale dhe specifikat tjera të secilit rast penal.

3.2.4. PK-ja ka të hartuara formularët e nevojshëm të punës, të cilët janë të harmonizuar me aktet ligjore në fuqi dhe të njëjtit u shërbejnë zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së veprimeve hetimore. Këta formularë duhet të aplikohen nga të gjitha drejtoritë hetimore. Formularët janë të vendosur në intranet, sistem ky në të cilin kanë qasje të gjithë zyrtarët policorë për t'u shërbyer me ta, me qëllim që të njëjtit t'i aplikojnë në veprimet e tyre policore. Gjatë analizimit të dosjeve hetimore, është vërejtur se format e përdorura brenda dosjeve hetimore nuk janë unike në kuadër të drejtorive hetimore dhe nuk ka një standard të hartimit të shkresave në të gjitha drejtoritë hetimore. Aplikimi i formularëve standard krijon kushte për një përdorim uniform të dokumenteve unike, duke përmbytur një standard të pasqyrimin të të dhënave, por edhe duke lehtësuar apo mundësuar prezantimin e plotë të tyre. Mosaplikimi i tyre konsiderohet më tepër si neglizhencë e personelit në përdorimin e tyre, andaj duhet mobilizuar në standardizimin e shkresave të tilla operacionale.

Rekomandimi nr. 5

IPK-ja u rekomandon menaxhmenteve të drejtorive hetimore që gjatë kryerjes së veprimeve hetimore, t'i aplikojnë formularët unikë që janë të harmonizuar me dispozitat ligjore në fuqi, me qëllim të krijimit të një dosjeje të standardizuar hetimore.

3.2.5. Secila shoqëri ka përgjegjësi dhe detyrë të mbrojtje, promovojë dhe të respektojë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ndër të tjera, duke ndërmarrë hapa të atillë që mund të jenë të nevojshëm për të krijuar të gjitha kushtet e domosdoshme që garantojnë bazë ligjore për të siguruar që të gjithë personat brenda juridiksionit të tij të mund t'i gëzojnë ato të drejta dhe liri në praktikë. Secili vend ndërmerr hapa legjislativ dhe administrativ të domosdoshëm për të siguruar që të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantohen efektivisht. Institucionet relevante të shtetit kanë rol të rëndësishëm në ngritjen e respektimit të të drejtave, duke bërë që çdo njeri të jetë subjekt vetëm i atyre kufizimeve që janë në pajtim me ligjet përkatëse për të drejtat e njeriut. Gjatë ushtrimit të autorizimeve policore që rrjedhin si rezultat i detyrave dhe përgjegjësive të parapara me ligj, PK-ja luan rol me rëndësi në mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Bazuar në nenin 125 të KPPK-së, në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, hetuesi i autorizuar nga Prokurori i Shtetit para marrjes në pyetje i lexon dëshmitarit apo të dyshuarit paralajmërimet mbi të drejtat e rezervuara nga ky Ligj dhe i njëjti po ashtu duhet të konfirmoj me shkrim mbi të kuptuarit e të drejtave nga ana e të intervistuarve. IPK-ja ka vlerësuar respektimin e këtyre të drejtave në procedurën paraprake, gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarit dhe dëshmitarit. Nga 24 dosje të kontrolluara, në tetë (8) prej tyre janë gjetur deklaratat që nuk i përmbajnë të drejtat e rezervuara të të dyshuarit, gjegjësisht të dëshmitarit (DHKO, DHTN, DHTQNJ). Në disa nga deklaratat që i përmbajnë të drejtat e të intervistuarve, ato të drejta nuk janë konform neneve të parapara në KPPK, mbi të drejtat e personit të dyshuar apo dëshmitarit. Po ashtu, është hasur në deklaratat që nuk janë nënshkruar nga marrësi i deklaratës. Në disa dosje, ka raste kur procesverbalet e marrjes në pyetje (deklaratat) nuk janë të nënshkruara as nga personat e dyshuar apo dëshmitarët e intervistuar (DHKEK, DHKO, DHTQNJ). Neglizhenca e hetuesve në rastet e tilla mund të sjellë efekte negative gjatë zhvillimit të fazave të mëvonshme të procedurës penale.

Rekomandimi nr. 6

IPK-ja u rekomandon zyrtarëve policor të hetimeve të kujdesen, që në fillim të marrjes në pyetje, dëshmitarit apo të dyshuarit t'i lexohen paralajmërimet mbi të drejtat e tyre konform dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe po ashtu në fund të marrjes në pyetje, këto procesverbale të mos procedohen pa nënshkrimin e palëve.

3.2.6. Vlerësim tjetër të cilin e ka bërë IPK me rastin e kontrollimit të dosjeve ka qenë vlerësimi i respektimit të aktvendimit mbi ndalimin e personit të arrestuar në rastet ku brenda rastit hetimor ka pas edhe persona të arrestuar. IPK-ja ka marrë Kodin e Procedurës Penale të Kosovës si kriter matës, konkretisht nenet që rregullojnë çështjet e arrestim/ndalimit dhe PSO-në që trajton mënyrën e procedimit, unifikimin e formularëve, kushtet e ambientimit dhe akomodimin e personave të privuar nga liria (të ndaluar) në Qendrat e Mbatjes. Në kuadër të këtij kriteri është bërë vlerësimi i aplikimit të formularëve mbi të drejtat e personit të arrestuar, si dhe prezenca e aktvendimit mbi ndalimin. IPK-ja ka gjetur që në të gjitha dosjet hetimore në të cilat si pjesë e veprimeve hetimore ka qenë edhe kapja apo arrestimi i personave të dyshuar për veprë penale, zbatueshmëria dhe respektimi i këtyre të drejtave dhe vendimeve ka qenë në nivel të mirë, duke përmbushur standardin e kërkuar. IPK-ja inkurajon PK-në që edhe më tutje të ngritë efikasitetin në drejtim të respektimit të procedurave të arrestim-ndalimit dhe të drejtave të personave të privuar nga liria.

3.2.7. Veprimtaria e Policisë rreth zbulimit të veprës penale, gjetjes së kryesve dhe sigurimit të provave kurorëzohet me kallëzim penal që ky organ ia drejton Prokurorit të Shtetit. Në të shkruhen paraqiten provat e mbledhura dhe bashkë me të dorëzohen skicat, sendet, fotografi, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera dhe materialet tjera që kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës. Forma e kallëzimit penal nuk është e paraparë me ligj, me qëllim që edhe qytetarët të kontribuojnë në zbulimin e veprave penale dhe kryesve pa ndonjë formalitet të veçantë. Mirëpo, kallëzimi penal është obligator për organet zbatuese të ligjit siç është PK-ja, nga fakti që detyrohen t'i paraqesin veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare, për të cilat janë informuar apo janë në dijeni në një formë tjetër. Kallëzimi penal pavarësisht faktit që nuk ka formë të veçantë të hartimit, duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme bazike që ndikojnë në ngritjen e performancës policore në raport me bashkëpunimin me Prokurorinë. Të gjitha kallëzimet penale të pranuar me dosje hetimore kanë qenë të hartuara në nivel të kënaqshëm, duke pasur të qartë se ndaj kujt ushtrohet kallëzimi penal, organit të cilit i drejtohet si dhe veprimet e ndërmarra gjatë mbledhjes së informatave lidhur me veprën penale. Të gjitha kallëzimet penale të ushtruara ndaj personave të dyshuar kanë qenë të nënshkruara nga ana e mbikëqyrësve dhe nga zyrtarët policorë që kanë ushtruar ato. IPK-ja inkurajon hetuesit e drejtorive hetimore që në vazhdimësi të ngritin cilësinë e hartimit të kallëzimeve penale si dhe shkresave të tjera si pjesë të dosjeve hetimore.

3.2.8. Sipas ligjeve pozitive, i dyshuari ka të drejtë në mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale. Para çdo marrjeje në pyetje të të dyshuarve, Policia e udhëzon ata për të drejtën e tyre në angazhimin e mbrojtësve. Nga e drejta në mbrojtës mund të hiqet dorë, përveç në rastet e mbrojtësit të detyruar, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë mbi të drejtën e tij në mbrojtje. IPK-ja gjatë kontrollit të dosjeve hetimore ka vlerësuar respektimin e dispozitave ligjore të parapara në KPPK në deklaratat e të dyshuarve, në rastet ku prezenca e avokatit ka qenë e domosdoshme gjatë marrjes së deklaratës. Këto dispozita në të gjitha rastet hetimore kanë qenë në harmoni me nenin 57 të KPPK-së dhe duke vlerësuar lartë këtë gjendje, inkurajohen hetuesit e drejtorive hetimore në vazhdimin e mëtutjeshëm të respektimit të kësaj dispozitave ligjore në fuqi.

3.3. Indikatorët e performancës në hetimin dhe zbulimin e krimit

3.3.1. Performanca hetimore e Policisë paraqet tërësinë e veprimeve të ndërmarra dhe mënyrën se si ajo heton dhe zbulon rastet kriminale. Performanca pozitive në drejtim të luftimit të krimit paraqet edhe treguesin e qartë të besueshmërisë së këtij institucioni tek qytetarët. Hetimet penale përveç që iu referohen personave në fjalë për të mbledhur provat dhe për të ngritur dyshimin e arsyeshëm apo të bazuar, përfshijnë edhe një proces ligjor të përcaktuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Në drejtim të përmbushjes së këtyre obligimeve ligjore, PK-ja është angazhuar në ndërmarrjen e veprimeve brenda mandatit të saj ligjor. Bazuar në obligimet dhe përgjegjësitë që ka në pajtim me ligjet aktuale, PK-ja është angazhuar në hetime duke ndërmarrë veprime me qëllim të zbatimit të ligjit si detyrë reaktive policore.

3.3.2. Parandalimi dhe luftimi i krimit, përveç që është detyrë e secilit institucion, është edhe detyrë dhe obligim qytetarë, ku kontributi i tyre mund të jetë shumë dimensional meqë përmes krimit cenohet siguria e të gjithëve. Duke u nisur nga qëllimi i përbashkët për të siguruar një ambient të qetë dhe të sigurt, në nivel qeveritar janë hartuar politika dhe janë nxjerrë dokumente

strategjike që kanë për qëllim parandalimin dhe luftimin e krimit në Kosovë. Në nivel qeveritar janë hartuar strategji që obligojnë akterë të caktuar për t'u mobilizuar në drejtim të parandalimit dhe luftimit të krimit në Kosovë. Secila nga këto strategji ka caktuar edhe prioritetet, duke nxjerrë në pah pozitën dhe funksionin e PK-së si njërin ndër akterët kryesorë në zbatimin e këtyre strategjive, duke qenë e përkrahur nga mekanizmat tjerë shtetëror si: Gjykata, Prokuroria dhe agjencione të tjera zbatuese të ligjit. Në mesin e strategjive që vlen të përmenden janë:

- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore 2015-2019,
- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër krimit të organizuar 2012-2017,
- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër drogave 2012-2017,
- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër terrorizmit 2012-2017,
- Strategjia Kombëtare kundër korrupsionit 2013-2017,
- Strategjia Kombëtare për parandalimin e krimit 2013-2017,
- Strategjia Kombëtare për ri-integrimin e personave të ri-atdhesuar në Kosovë 2013-2018,
- Strategjia Kombëtare për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale.


3.3.3. Roli i PK-së si akter në implementimin e këtyre strategjive paraqet një angazhim permanent policor drejt parandalimit dhe luftimit të dukurive kriminale në fusha të caktuara. PK-ja në kuadër të aktivitetit planifikues strategjik ka hartuar Planin Zhvillimor Strategjik (2016-2020), që ka për synim arritjen e krijimit të një policie profesionale, të trajnuar, të pajisur mirë, efikase në ofrim të sigurisë, në zbatim të ligjit, parandalim dhe luftim të krimit, duke qenë shembull në rajon, gjithnjë në mbështetje dhe besnike ndaj komunitetit. Të gjitha subjektet e inspektuar kanë bërë planifikimet vjetore varësisht nga zhvillimi i trendit të krimit, duke u mbështetur në kapacitetet e tyre humane dhe teknike, për të ulur dhe parandaluar numrin e veprave kriminale dhe për të zbardhur kryesit e tyre. PK-ja në mënyrë të vazhdueshme ka qenë e angazhuar në sensibilizimin e qytetarëve në ndihmën kundër dukurive kriminale, duke zhvilluar debate të ndryshme me institucione të tjera për raportimin me kohë të veprave penale, takime me qytetarët, aktivitetet në shkolla për të njoftuar me pasojat e përdorimit të narkotikëve dhe aktivitete të tjera me karakter sensibilizues.

3.3.4. Departamenti i Hetimeve është i angazhuar të zhvillojë aktivitete të ndryshme operative hetimore për të parandaluar aktivitetin kriminal, për të luftuar grupet kriminale, për të arrestuar të dyshuarit dhe për të identifikuar rrugët përmes të cilave kryhen veprat kriminale. Diagrami tregon një performancë pozitive policore në luftimin e krimit. Në diagram janë përfaqësuar tregues që pasqyrojnë trendin pozitiv të luftimit të krimit në përgjithësi. Fillimisht mund të konstatojmë se kemi ngritje të aktivitetit kriminal që dëshmohet nga numri i rasteve të trajtuara brenda vitit. Kemi shtim të numrit të rasteve për 29% në krahasim me vitin 2015 (nga 1.649 në 2.120 raste). Nuk janë raste të gjitha të reja, por në këto shifra janë përfshirë edhe rastet e bartura nga vitet e kaluara.

3.3.5. Numri i kallëzimeve penale të ngritura në Prokurorinë e Shtetit ka shënuar ngritje për 53% në krahasim me vitin paraprak (*shih diagramin*). DHTN përfaqësohet me 726 kallëzime apo me 53% të të gjitha kallëzimeve të ngritura në nivel Departamenti, që është 1.370 sosh për vitin 2016. DHKEK përfaqësohet me 403 kallëzime penale të ngritura apo 29% të të gjitha kallëzimeve të ngritura në vitin 2016. Këto shifra tregojnë ngritjen e nivelit të kriminalitetit në vend në fushën e trafikut me narkotikë dhe krimeve ekonomike dhe korrupsionit. Ngritja e numrit të rasteve në këto kategori ka ardhur përshkak të shkallës së ulët të zhvillimit ekonomik, vetëdijes shoqërore, brishtësisë politike dhe ekonomike por edhe pozitës gjeo-strategjike të vendit tonë që shërben si

udhëkryq dhe rrugë tranziti për trafiqe të drogës. DHTN dhe DHKEK janë drejtoritë e ngarkuara me numrin më të madh të rasteve. Inkurajohet Departamenti i Hetimit që të vazhdojë me aktivitetet në parandalim dhe luftim të këtyre aktiviteteve kriminale, që ndikojnë direkt negativisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

3.3.6. Angazhimet pro-aktive dhe reaktive policore në luftën kundër krimit në përgjithësi kanë shënuar ngritje të theksuar, nëse u referohemi treguesve të pasqyruar në diagramin e prezantuar. Policia në vazhden e aktiviteteve të saj operative ka ngritur numrin e operacioneve operative për 57% krahasuar me vitin 2015 dhe operacionet e realizuara kanë rezultuar me numër të shtuar të të arrestuarve. Shënohet ngritje e numrit të të arrestuarve për 54% krahasuar me vitin 2015. Treguesit e performancës shënojnë trende pozitive edhe sa i përket angazhimeve policore në kryerjen e bastisjeve dhe kontrollit të lokaleve. Numri i bastisjeve dhe kontroleve të lokaleve ka shënuar ngritje për 93%, përkatësisht 40% në krahasim me vitin 2015.



3.3.7. Duke u nisur nga fakti se DHKEK dhe DHTN janë drejtoritë hetimore me numrin më të madh të rasteve kriminale, me të cilat janë ngarkuar në dy vitet e fundit, IPK-ja është interesuar të llogarisë ngarkesën e hetuesve me numër të rasteve dhe kallëzime të ngritura në Prokurorinë e Shtetit. Sipas analizës së Raportit Vjetor të Departamentit të Hetimeve për vitin 2016, DHTN është ngarkuar me gjithsej 961 raste për hetim, me kapacitete të disponueshme të burimeve njerëzore prej 90 zyrtarëve të uniformuar⁴. Kjo Drejtori ka ngarkuar çdo zyrtar me nga afërsisht 11 raste penale, të cilët kanë kryer detyra hetimore me një efikasitet prej tetë (8) kallëzimeve penale të ngritura në vit. DHKEK është ngarkuar me gjithsej 547 raste, me kapacitete të disponueshme të burimeve njerëzore prej 128 zyrtarëve të uniformuar. Kjo Drejtori ka ngarkuar çdo zyrtar me nga afërsisht katër (4) raste penale, të cilët kanë kryer detyra hetimore me një efikasitet prej tre (3) kallëzimeve penale të ngritura brenda vitit.

⁴ IPK-ja ka parasysh se edhe personeli i graduar trajton raste penale dhe në rastin konkret, bazë për llogaritje të ngarkesës me numër të rasteve penale, është marrë numri i përgjithshëm i punonjësve të uniformuar, ngase nuk ka mundur të bëhet një prerje se cilat nivele janë ngarkuar me raste, përveç hetuesve pa grada.

3.3.8. Në drejtim të goditjes së krimit brenda shoqërisë kosovare, PK-ja ka ngritur bashkëpunimin edhe me akterë tjerë, roli i të cilëve është i pazëvendësueshëm në këto sfida. Bazuar në raportet policore, vërehet një bashkëpunim i ngushtë me akterët e luftimit të krimit të shtrirë në tre drejtime. Bashkëpunimi ndër-institucional është evidentuar me Prokurorinë e Shtetit, Administratën Tatimore të Kosovës, Doganat e Kosovës, Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara, Njësinë e Inteligjencës Financiare, Agjencinë Kunder Korrupsionit, etj. Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, vihet në pah bashkëpunimi me Policinë e Shtetit, autoritetet austriake, etj. Në gjithë angazhimet policore nuk duhet anashkaluar edhe bashkëpunimin me Misionin Evropian për Sundimin e Rendit dhe Ligjit në Kosovë (EULEX). Në të gjitha këto rrafshë bashkëpunimi janë siguruar informata mbi krimin, janë realizuar takime, operacione dhe hetime të përbashkëta. Mbështetje luftës kundër krimit i kanë dhënë edhe OSBE, ICITAP, të cilët kanë dhënë mbështetje profesionale dhe teknike. Çmohet bashkëpunimi i Departamentit të Hetimit, me akterët e përfshirë në luftimin e të gjitha krimeve që mund të rrezikojnë ekonominë dhe sigurinë e vendit.

3.3.9. Bashkëpunimi me Prokurorinë është pjesë organike e veprimtarisë policore në luftë kundër krimit. PK-ja nuk është në gjendje të luftojë me efektivitet krimin pa bashkëpunim, koordinim, bashkërendim dhe mbështetje të Prokurorisë së Shtetit, pasi që ky është organi që finalizon gjithë veprimtarinë për zbulimin dhe dokumentimin e veprave penale dhe autorëve të tyre. Nevoja për të bashkërenduar përpjekjet, mbështetur njëri-tjetrin dhe koordinuar çdo veprim kundër krimit është domosdoshmëri, vëmendje ndaj zhvillimit të krimit dhe rritje e pro-aktivitetit dhe bashkëpunimit. Kuadri ligjor për bashkëpunim në mes të PK-së dhe Prokurorisë në hetimin e krimit është në masë të madhe i përcaktuar dhe hollësisht i specifikuar nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Ligji për Policinë. Megjithatë, problemet ndodhin gjatë bashkëpunimit praktik që shkaktohet nga mungesa e bazës së duhur të të dhënave. Është parë që kthimi i informatave për rastet e proceduara me aktet e veçanta juridike të parapara me ligj në mes të Policisë dhe Prokurorisë nuk është në nivelin e duhur. Mungojnë informatat mbi ngritjen e aktakuzave për kallëzimet penale të ngritura nga PK-ja për rastet e proceduara në Prokurori. Është evidente edhe mungesa e informatave kthyesë edhe për rastet e hudhjes së kallëzimeve penale dhe raporteve të veçanta nga Prokuroria. Një bashkëpunim dhe koordinim i mirëfilltë në mes të dy institucioneve do të ndihmonte që PK-ja të ketë njohuri mbi zhvillimin e rasteve që kanë qenë veprime policore të ndërmarra për rastet e proceduara në këtë institucion. Mungesa e komunikimit ndikon në vlerësimin e drejtë të performancës dhe efektivitetit të hetuesve në veprimet hetimore.

3.3.10. PK-ja së bashku me disa agjenci të tjera të zbatimit të ligjit kanë ndërmarrë hapa të duhur për të themeluar një infrastrukturë të përshtatshme të bashkëpunimit ndër-institucional, me ç'rast është hartuar Udhëzuesi i dizajnuar për Prokurorinë e Shtetit, PK-në dhe IPK-në, për të fuqizuar kapacitetet për hetimin dhe luftimin e krimit, si dhe administrimin me dosjet penale. Ky Udhëzues do të duhej të përfshinte shtojcën me formularët e bashkëngjitur, me qëllim që përdoruesit si nga Prokuroria, po ashtu edhe zyrtarët policorë, të kenë informata apo prezantime gjithëpërfshirëse mbi disa nga hapat e procedurave paraprake dhe penale. Udhëzuesi ka synim që të përmirësojë krijimin e një regjistri të hetimeve dhe ndjekje të krimeve, rritjen dhe forcimin e mekanizmit të brendshëm mbikëqyrës rreth kompletimit të dosjes penale. Udhëzuesi edhe pse është hartuar, shtypur dhe nënshkruar nga institucionet, nuk ka arritur të gjejë zbatim për shkak se formularët standard të saj nuk janë nxjerrë.

3.3.11. Kontributi i drejtorive hetimore nuk do të ishte në këtë shkallë edhe pa mbështetjen e DIA-se, e cila përveç pranimit dhe shpërndarjes së informatave, kontribuon edhe në asistime në terren nga njësitë fushore të inteligjencës. Bazuar në Raportin Vjetor të Departamentit të Hetimeve, DIA për vitin 2016 ka nxjerrë gjithsej 154 raporte analitike dhe 344 vlerësime të rrezikshmërisë dhe situatës së sigurisë, e që janë për 7%, përkatësisht 6% më shumë se në vitin 2015. Është biseduar me drejtuesit e drejtorive hetimore për të parë performancën e shkëmbimit të informatave në mes të drejtorive mbështetëse dhe operative të Departamentit të Hetimeve. DIA që bën grumbullimin, trajtimin, analizimin dhe shpërndarjen e informatave inteligjente në drejtoritë operative hetimore, pranon në numër shumë të vogël informatave kthyesë mbi zhvillimin e mëtejshëm të informatave në rastet kur ato përbëjnë elemente për të filluar raste hetimore penale. Për një përqindje vogël të informatave të analizuarra e të shpërndara në drejtoritë hetimore, DIA ka njohuri për rrjedhën e zhvillimit të tyre lidhur me personat e dyshuar apo dukurive kriminale, për të cilat pranohen ato. Kjo sjellë angazhim të shumëfishtë të analizimit të të njëjtave informata lidhur me veprat e dyshuara dhe personat e dyshuar. Respektimi i rregullit mbi kthimin e informatave nga drejtoritë operative hetimore drejt DIA-së, shpie në vlerësimin më të drejtë të burimeve të caktuara informative, të cilat deponojnë informata në këtë Drejtori.

Rekomandimi nr. 7

IPK-ja u rekomandon drejtorive hetimore që të rrisin bashkëpunimin lidhur me kthimin e informatave tek DIA, në mënyrë që kjo drejtori të përmbushë detyrimet e saja në të ardhmen lidhur me shpërndarjen e informacionit dhe analizimit sa më efikas të këtyre informatave.

3.4. Raportimi i rasteve dhe menaxhimi i vendit të ngjarjes

3.4.1. Pas raportimit të rasteve nga ankuesit, viktimat, dëshmitarët, apo në cilëndo mënyrë tjetër të raportimit për një vepër penale e që kërkohet reagim policor, është obligim primar i patrullës policore që të përgjigjet në rast dhe të dalë në vendngjarje. Nëse patrulla vlerëson që ka gjurmë që shpiejnë deri te zbulimi i rastit, është e obliguar të njoftojë që në vendngjarje të merr pjesë njësi përkatëse e teknikës kriminalistike. Në rastet kur kjo Njësi njoftohet për një dyshim të veprës penale, kuptohet se kemi të bëjmë me incidente të rënda apo të profilit të lartë. Ndarja e përgjegjësive bazohet në PSO-në PK/SHH-PSO 1.21⁵, e cila u dedikohet për zbatim Njesisë së Kontrollit Kualitativ të Teknikës Kriminalistike (NJKKTK), njësive të teknikës kriminalistike, sektorëve të vendit të ngjarjes në nivel të hetimeve rajonale dhe atyre të stacioneve policore. Edhe pas transformimit të NJKKTK-së në Drejtori të Teknikës Kriminalistike (DTK), Drejtoria që nga viti 2012 ende operon me këtë PSO të pa harmonizuar me aktet më të larta.

3.4.2. Mbledhja e dëshmimeve është jetike në çdo vendngjarje të krimit dhe gjithnjë synohet të ruhet integriteti i tyre, në mënyrë që të parandalohet kontaminimi i dëshmimeve dhe të trajtohen në mënyrën e përcaktuar me ligj. IPK-ja ka siguruar nga DTK-ja, katër (4) dosje të rasteve penale për të bërë vlerësimin e veprimeve që janë ndërmarre nga krim-teknikët gjatë marrjes së dëshmimeve në vend ngjarje. Gjatë analizimit të dosjeve hetimore, është bërë vlerësimi lidhur me mbledhjen e dëshmimeve në vendin e ngjarjes dhe është vërejtur se të gjitha veprimet e ndërmarra në këto raste kanë qenë konform dispozitave që parashihen në PSO-në mbi vendin e ngjarjes, e cila nuk është e azhurnuar

⁵ Procedura Standarde e Operimit të Teknikës Kriminalistike- Sektori i vendit të ngjarjes”, datë 12.04.2012.

me ligjet kryesore që kanë pësuar ndryshime. Metodologjia e përdorur gjatë mbledhjes së provave, qasja në vendngjarje dhe sigurimi i saj nga kontaminimi eventual, vlerësohet të jetë përdorur në mënyrë profesionale nga njësitë e teknikës kriminalistike. Inkurajohet personeli i Drejtorisë që edhe në të ardhmen t’i kushtojë kujdesin e shtuar vendngjarjeve, meqë provat e siguruara paraqesin mjetin për dëshmimin e krimeve të ndodhura dhe provimin e fajësisë së atyre që shkaktojnë krimin.

3.4. Evidentimi, trajtimi dhe ruajtja e dëshmive

3.4.1. Një nga detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë është gjetja dhe ruajtja e provave të veprave penale që mund të përdoren në procedurë penale. Operacionet policore në të shumtën e rasteve përcillen me gjetjen dhe konfiskimin e sendeve në vendngjarje. Administrimi i sendeve, pasurisë, provave apo parave të gjetura/të konfiskuara, është sfidë dhe preokupim i institucioneve të zbatimit të ligjit që lidhet direkt me detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë. Bazuar në KPPK, sendet dhe pasuria e sekuestruar përkohësisht janë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e Prokurorit të Shtetit. Prokurori i Shtetit mund t’ia delegojë mbikëqyrjen dhe kontrollin zyrtarit të autorizuar të Policisë për sendet dhe pasurinë e sekuestruar përkohësisht. Policia sfidohet në trajtimin dhe ruajtjen e dëshmive, të cilat në procedurë penale konsiderohen si hallka kryesore që lidhë të dyshuarin me krimin. IPK-ja ka analizuar Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës me të cilën rregullohet fusha e konfiskimit të sendeve, që mund të jenë prova gjatë një procedure penale ose që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të cilat ligji parasheh konfiskim apo sekuestrim. Është analizuar edhe Procedura Standarde e Operimit për Dhomat e Dëshmive lidhur me vendosjen, trajtimin dhe ruajtjen e sendeve, pasurisë, provave të konfiskuara në nivel lokal dhe qendror. Kjo ofron udhëzime konkrete dhe krijon standarde të menaxhimit dhe të administrimit të dëshmive.

3.4.2. Në bazë të Programit të punës inspektuese, inspektorët kanë përpiluar një pyetësor bazuar në Procedurën Standarde të Operimit, i cili ka përfshirë tre (3) objektiva, duke përfshirë funksionet e Dhomës Qendrore të Dëshmive, si: krijimin e kushteve për pranimin dhe ruajtjen e dëshmive (pajisjet - inventarët në dhomën e dëshmive), trajtimin dhe ruajtjen, sigurinë, paketimin- shënimet, si dhe evidentimin e sendeve dhe dëshmive të konfiskuara apo sekuestruara. Pyetësori ka përfshirë 33 pyetje (çështje/fusha), të shpërndara në objektivat e cekura më lartë dhe për të cilat është dashur të merren përgjigje konkrete në Dhomën Qendrore të Dëshmive. Pyetjet kanë ngërthyer një proces verifikimi për të vërtetuar se vendosja e dëshmive është bërë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Përmes 19 pyetjeve është synuar të vlerësohet mënyra e ruajtjes dhe evidentimit të sendeve të sekuestruara. Vlerësohet se gjetjet kanë rezultuar pozitive dhe në harmoni të plotë me kriteret e ruajtjes dhe evidentimit të sendeve, përveç një pike që ka të bëjë me vendosjen dhe paketimin e dëshmive, varësisht prej specifikave të tyre, ku është gjetur se brisqet e rrojës dhe shiringat nuk trajtohen dhe nuk ruhen në kontejnerë të veçantë siç parashihet në PSO. Kjo vjen si mungesë e pajisjes me kontejnerë për ruajtjen e këtyre dëshmive.

Rekomandimi nr. 8

IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të Dhomës Qendrore të Dëshmive që me rastin e pranimit të dëshmive nga hetuesit e rasteve, të sigurohen se dëshmitë janë të paketuara në paketime adekuate, varësisht prej specifikave të tyre, për t’u ruajtur nga dëmtimet e mundshme.

3.4.3. Nga 24 dosje penale që IPK-ja ka marrë nga drejtoritë qendrore të hetimeve për të vlerësuar veprimet hetimore paraprake të Policisë, katër (4) nga to janë të lidhura me sende të konfiskuara në vendngjarje, e të cilat ruhen në Dhomën Qendrore të Dëshmive. Inspektorët kanë identifikuar sendet dhe dëshmitë e tilla në Dhomën Qendrore të Dëshmive dhe ka vlerësuar ruajtjen, paketimin dhe evidentimin e tyre. Sendet dhe dëshmitë që janë lidhur me dosjet e përzgjedhura dhe që ruhen në Dhomën Qendrore të Dëshmive, kanë qenë të paketuara dhe të shënuara në mënyrën e duhur dhe kanë përmbushur standardin e kërkuar. Gjatë ruajtjes së dëshmive është respektuar zinxhiri i ruajtjes dhe mënyra e shënimit të tyre sipas dispozitave të parapara në PSO. Dëshmitë kanë qenë të ndara, të vendosura dhe të paketuara për ruajtje, varësisht prej specifikave të tyre. Edhe ruajtja ekuivalente e tyre është e regjistruar si në Librin e dëshmive, ashtu edhe në Bazën elektronike në të cilën futen të dhënat e të gjitha dëshmive. IPK-ja inkurajon personelin e Dhomës Qendrore të Dëshmive për përkushtimin në trajtimin dhe ruajtjen e dëshmive sipas rregullave të përcaktuara. Bazuar në formularin e verifikimit të përmbushjes së standardeve të punës, është konstatuar se nga 33 standarde të verifikuara, 13 prej tyre kanë pasur për qëllim të vlerësojnë nivelin e sigurisë dhe kushteve teknike në Dhomën Qendrore të Dëshmive. Bazuar në PSO, kriteret e përcaktuara mbi sigurinë dhe kushtet teknike, në 12 pika, gjetjet kanë rezultuar pozitive konform PSO-së, ndërsa në një pikë, rezulton se kemi përmbushje të pjesshme në raport me standardin e kërkuar. Këtu i referohemi standardit sipas kriterit të përcaktuar në grupin C, pika 10 e PSO-së, që ‘dhoma e Dëshmive duhet të jetë e pajisur me solucion për larjen urgjente të syve’ që ka rol të madh në rastet e caktuara për shëndetin e personelit që punon aty.

3.4.4. Dhoma Qendrore e Dëshmive është e vendosur në vend të përshtatshëm brenda ndërtesës së Policisë. Dera e saj është e punuar nga metali. Dhoma është e pajisur me mjete për fikjen e zjarrit, detektorë tymi, alarme funksionale kundër zjarrit, alarm funksional kundër ujit. Dhoma u siguron qasje të kufizuara, personave që e vizitojnë atë. Bazuar në PSO, kjo Dhomë ka standardet e kërkuara për të dëshmuar nivelin e sigurisë. Rëndësi të posaçme ka edhe mënyra e sistemimit të dëshmive dhe sendeve nëpër vendet e caktuara në Dhomën e Dëshmive, varësisht nga specifikat e tyre. Zyrtari përgjegjës i Dhomës mban evidencë për sistemin e numrit, emërtimin e raftit dhe udhëzimin se ku gjenden dëshmitë apo sendet e deponuara. Zyrtari përgjegjës ka qenë i gatshëm për të identifikuar në kohë të shkurtër dëshmitë e deponuara me listat e dëshmive si dhe zinxhirin e ruajtjes, të cilat kanë qenë të plotësuar në mënyrën e duhur për secilën dëshmi të kërkuar.

3.5. Administrimi i dosjeve kriminale

3.5.1. Është e njohur se drejtoritë hetimore administrojnë me numër të konsideruar të dosjeve me natyrë të ndjeshme penale. Sipas rregullave në fuqi, dosjet e tilla është e nevojshme të mbahen në pronësi të drejtorive hetimore në cilësi të fond-krijuesit, deri në momentin kur konsiderohen si lëndë të përfunduara. Pas përmbylljes së kësaj periudhe që sipas rregullave është dy (2) vjeçare, dokumentet e tilla drejtohen në Arkivin⁶ Qendror për ruajtje sipas afateve të ruajtjes të përcaktuara me Ligjin për Arkivat. Bazuar në Rregulloren për ruajtjen dhe qasjen në dokumentacionin zyrtar⁷, fondi-krijuesi, i cili nuk e ka dorëzuar dokumentacionin për arkivim në Arkiv Qendror, por ende e ka nën mbikëqyrje të vet, është i obliguar që të sigurojë lokacion/hapësirë të mjaftueshme, pajisje

⁶ Arkivi është hapësirë për administrim të dokumenteve, lëndëve, regjistrave, shkresave e materialeve tjera që duhet të ruhen në vende të posaçme që ofrojnë kushte për ruajtje dhe janë të organizuara sipas akteve ligjore në fuqi.

⁷ Neni 5, paragrafi 3 i Rregullores nr. 13/2015 për ruajtjen dhe qasjen në dokumentacionin zyrtar.

dhe mjete të nevojshme për ruajtje dhe shfrytëzim të këtij dokumentacioni, të klasifikojë dhe të sistemoj materialin arkivor dhe në vazhdimësi të bëjë përzgjedhjen apo ndarjen e dokumentacionit pavlerë, të mbajë materialin arkivor në gjendje të rregullt dhe ta ruajë nga dëmtimi për deri sa të dorëzohet në Arkiv Qendror. Dispozitat e Rregullores janë të obligueshme për njësitë policore, të cilat gjatë punës së tyre krijojnë dokumentacion zyrtar, i cili dërgohet për arkivim në arkivat e PK-së. Me qëllim që të percaktoj veprimet policore lidhur me trajtimin e duhur të dokumenteve zyrtare që kanë vlerë për arkivim, PK-ja ka përpiluar Procedurën Standarde të Operimit (DSHB-1.05) për Menaxhimin e Dokumenteve Arkivore, të cilës duhet t'i nënshtrohen për zbatim të gjitha drejtoritë hetimore. Kjo PSO përcakton mënyrën e ruajtjes, administrimit, mbrojtjes dhe qasjes së avancuar në këto dokumente.

3.5.2. IPK-ja ka inspektuar shtatë (7) arkiva të dosjeve në drejtoritë hetimore dhe ka parë nivelin e sigurisë, kushtet e ruajtjes dhe mënyrën e administrimit me dosje. Është bërë kontrolli i dhomave të dosjeve për të parë mënyrën e trajtimit të dosjeve dhe kushtet në të cilat ruhen ato. Pyetësori i përgatitur nga inspektorët e IPK-së ka trajtuar sigurinë fizike në dhoma, inventarizimin/pajisjet teknike të arkivit, arkivimin elektronik dhe qasjen në hapësirat e arkivave të dosjeve. Nuk është hasur në dhoma që plotësojnë të gjitha standardet për arkivim të dosjeve. Ato janë të vendosura në hapësira të adaptuara, të destinuara për dhoma pune dhe inventari i vendosur brenda tyre nuk mundëson ruajtje, vendosje dhe sistemim në mënyrën e duhur të dokumenteve. Po ashtu, nuk e kanë sigurinë e duhur të lëndëve nga faktorët dëmtues. Në përgjithësi, inventari brenda dhomave të dosjeve nuk i plotëson kushtet e parapara si në aspektin fizik ku janë të vendosura dosjet, ashtu dhe aspektet tjera (ajrosja, lagështia, sistemimi, etj).

3.5.3. Në shtatë (7) nga dhomat e inspektuara të dosjeve, dyert e tyre të hyrjes nuk kanë qenë të përpunuara nga metali dhe rezistente ndaj zjarrit. Brenda hapësirave nuk është gjetur sistem i monitorimit me kamera. Në gjashtë (6) nga shtatë (7) arkiva të dosjeve ka pasur aparat për shuarjen e zjarrit afër pjesës hyrëse të arkivit, kurse në një arkiv (DTK) nuk ka pasur aparat të tillë. Aparatet që kanë qenë në vendin e duhur gjatë inspektimit, kanë qenë me afat të skaduar. Aparatet kundër zjarrit me afat të skaduar janë hasur në DKT, DHKEK DHTN dhe DHTQNJ. Në pesë (5) dhoma të dosjeve, inventari ka qenë nga druri dhe të njëjtit në të shumtën e rasteve kanë qenë me hapësirë të kufizuar për vendosjen e dosjeve. Edhe pse disa nga drejtoritë hetimore kanë zgjeruar hapësirat fizike në të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre, nuk është krijuar një zgjidhje e mirëfilltë për arkiva brenda tyre. Ato janë të adaptuara dhe brenda tyre nuk ka kushte të përshtatshme, stabilimente që sigurojnë temperaturë konstante për ruajtjen e dosjeve për t'iu shmangur dëmtimit. Në DHKR, një pjesë e dosjeve dhe dokumenteve ruhen në zyre të personelit administrativ, pasi që në momentin e inspektimit arkiva e dosjeve ka qenë jofunksionale. Drejtuesit e kësaj Drejtorie janë deklaruar se janë duke punuar rreth sistemimit të arkivës në një hapësirë më të përshtatshme. Edhe në DHKEK një pjesë e dosjeve ruhen në zyrat e zyrtarëve policorë, për shkak të mungesës së hapësirës.

3.5.4. Sistemimi i dosjeve është diktuar nga iniciativat personale të zyrtarëve policorë përgjegjës të dhomave të dosjeve dhe mbikëqyrësit e tyre. Në dhomat e dosjeve penale nuk ka Listë njoftuese apo Libër fizik që tregon vendin e sistemimit të dosjes dhe përmbajtjen e saj. Ekzistojnë librat për evidentim fizik të rasteve/lëndëve penale nga njësitë hetimore për rastet e iniciuara në kuadër të drejtorive, por nuk është hasur në libra fizik me informata mbi dokumentacionin e përgjithshëm, të cilat gjenden brenda arkivave në drejtoritë hetimore. Inspektorët kanë vrotuar procedurën e

qasjes në dhomat e dosjeve penale nga persona të paautorizuar dhe kanë konstatuar se tre (3) nga shtatë (7) arkiva, mbajnë regjistër për evidentim të hyrje-daljeve të personave të pa autorizuar në këto hapësira, kurse katër (4) dhoma të dosjeve (DHKO, DHTN, DHKR dhe DKT) në momentin e inspektimit nuk kanë pasur në dispozicion regjistra për evidentim të hyrje-daljeve.

3.5.5. PSO-ja obligon departamentet, divizionet, drejtoritë rajonale si dhe sektorë të tjerë që t'i përmbahen udhëzimeve mbi mënyrën e ruajtjes së dokumenteve si lëndë arkivore. Përveç arkivimit në formë fizike të dokumenteve, kjo përcakton se arkivi duhet të ketë edhe evidentimin elektronik të dokumenteve. Dosjet elektronike duhet të ruhen në mënyrë elektronike nën masa të larta të sigurisë. Kjo mënyrë e arkivimit duhet të jetë e mbrojtur dhe në të duhet të kenë qasje vetëm personat e autorizuar. Gjatë inspektimit është trajtuar me kujdes edhe arkivimi elektronik dhe vlerësohet se vetëm në DHKEK ka tendencë të zhvillimit të një sistemi të brendshëm të arkivimit elektronik, por ky sistem nuk i plotëson kriteret e sigurisë edhe pse qasja në këtë sistem është e kufizuar. Qasje kanë vetëm zyrtarët policorë të autorizuar dhe çdo ndërhyrje në të, lë gjurmë dhe identifikohet me kodin e qasjes së zyrtarit policor. Kjo mënyrë e arkivimit është bërë me iniciativën e zyrtarëve policorë që menaxhojnë me arkivë në këtë drejtori dhe si e tillë kjo arkivë elektronike është ende e pa kompletuar. Arkivat tjera nuk e kanë një sistem të tillë të arkivimit.

Rekomandimi nr. 9

IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit të Hetimeve që në bashkëpunim me drejtoritë hetimore në cilësi të fond-krijuesit të dosjeve, të anaizojë dhe vlerësojë gjendjen brenda arkivave të dosjeve dhe të ndërmarr hapat e nevojshëm drejt përmbushjes së obligimeve që dalin nga neni 5, paragrafi 3 i Rregullorës për ruajtje dhe qasjen në dokumentacionin zyrtar.

4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 12.12.2017, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit të Hetimeve që të rishikojë dhe plotësojë të gjitha PSO-të, të cilat nuk janë të azhurnuara me aktet më të larta ligjore, me qëllim të ngritjes së përgjegjësisë në mënyrën e kryerjes së detyrave nga ana e zyrtarëve policorë.</i>	I	<i>Rekomandimi qëndron. Departamenti i Hetimeve tani më është duke rishikuar dhe plotësuar të gjitha PSO-të të cilat nuk janë të azhurnuara me aktet më të larta ligjore</i>	Qershor 2018
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Departamentit të Hetimeve që në bashkëpunim me Departamentin për Burime Njerëzore, që të plotësojë strukturën e personelit në drejtoritë e hetimeve në përputhje me Listën e Autorizuar të Personelit, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për punë efikase në luftën kundër kriminalitetit dhe zbardhjes së rasteve penale.</i>	I	<i>Rekomandimi qëndron. Departamenti i Hetimeve është duke punuar në vazhdimësi në këtë drejtim dhe në disa drejtori në përgjithësi është plotësuar struktura e personelit, në disa ka filluar ky proces, mirëpo për këtë çështje gjithmonë duhet pasur parasysh lëvizjet e personelit dhe ndryshimet në strukturë.</i>	Dhjetor 2018
3.	<i>IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit të Hetimit, që në kuadër të bashkëpunimit me Prokurorinë dhe Gjykatat, të ngritë çështjen e mungesës së komunikimit të informatave, me qëllim që të dihet mbi statusin e rasteve gjatë fazave të procedurës penale dhe këto të dhëna të futen në bazën e të dhënave të Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK).</i>	I	<i>Rekomandimi qëndron. Departamenti i Hetimeve ka një bashkëpunim të mirë me Prokurorinë dhe Gjykatat dhe me qëllim të plotësimit të këtij rekomandimi në takimet e ardhshme do të ngrit këtë çështje dhe do të kërkojë dhe insistojë që bashkëpunimi të forcohet edhe më shumë me qëllim që të dihet mbi statusin e rasteve gjatë fazave të procedurës penale dhe këto të dhëna të futen në bazën e të dhënave të Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK).</i>	Mars 2018
4.	<i>IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit të Hetimeve që të sigurohet që në rrethanat kur gjatë fazës paraprake të hetimeve vie deri</i>	I	<i>Rekomandimi qëndron. Menaxhmenti i Departamentit të Hetimeve në të ardhmen do të shtojë mbikëqyrjen dhe kontrollin</i>	Qershor 2018

	<i>tek 'dyshimi i arsyeshëm' se është kryer një vepër penale, brenda 24 orëve të respektohet dispozita ligjore nga KPPK-ja për t'i dorëzuar Prokurorit kompetent të Shtetit, raportin policor njoftues.</i>		<i>në mënyrë që të respektohen të gjitha dispozitat ligjore nga KPPK.</i>	
5.	<i>IPK-ja u rekomandon menaxhmenteve të drejtorive hetimore që gjatë kryerjes së veprimeve hetimore, t'i aplikojnë formularët unikë që janë të harmonizuar me dispozitat ligjore në fuqi, me qëllim të krijimit të një dosjeje të standardizuar hetimore.</i>	I	<i>Rekomandimi qëndron. Menaxhmenti i Drejtorive hetimore do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që në të ardhmen gjatë kryerjes së veprimeve hetimore të aplikohen formularët unik.</i>	Mars 2018
6.	<i>IPK-ja u rekomandon zyrtarëve policor të hetimeve të kujdesen, që në fillim të marrjes në pyetje, dëshmitarit apo të dyshuarit t'i lexohen paralajmërimet mbi të drejtat e tyre konform dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe po ashtu në fund të marrjes në pyetje, këto procesverbale të mos procedohen pa nënshkrimin e palëve.</i>	I	<i>Rekomandimi qëndron. Menaxhmenti i Drejtorive hetimore do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe do të shtoj mbikëqyrjen që në të ardhmen të respektohet kjo dispozitë ligjore sipas KPPK-së.</i>	Mars 2018
7.	<i>IPK-ja u rekomandon drejtorive hetimore që të rrisin bashkëpunimin lidhur me kthimin e informatave tek DIA, në mënyrë që kjo drejtori të përmbushë detyrimet e saja ne te ardhmen lidhur me shpërndarjen e informacionit dhe analizimit sa më efikas të këtyre informatave.</i>	I	<i>Rekomandimi qëndron. Në përgjithësi ekziston një bashkëpunim dhe komunikim i mirë në mes të drejtorive të hetimeve dhe DIA-së, mirëpo në të ardhmen do të insistohet që të mbahen takime edhe më të shpeshta për forcim të bashkëpunimit dhe kthimin e informatave tek DIA</i>	Qershor 2018
8.	<i>IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të Dhomës Qendrore të Dëshmimeve që me rastin e pranimit të dëshmimeve nga hetuesit e rasteve, të sigurohen se dëshmitë janë të paketuara në paketime adekuate, varësisht prej specifikave të tyre, për t'u ruajtur nga dëmtimet e mundshme.</i>	I	<i>Siç dihet Dhoma Qendrore e Dëshmimeve nuk është nën mbikëqyrje të Departamentit të Hetimeve por në kuadër të bashkëpunimit do të ngritët kjo çështje dhe do të kërkohet edhe nga zyrtarët përgjegjës që dëshmitë të ruhen dhe paketoohen në paketime adekuate.</i>	Qershor 2018
9.	<i>IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit të Hetimeve që në bashkëpunim me drejtoritë hetimore në cilësi të fond-krijuesit të dosjeve, të anaizojë dhe vlerësojë gjendjen</i>	I	<i>Rekomandimi qëndron. Menaxhmenti i Departamentit të Hetimeve është i vetëdijshëm për këtë problematik andaj përkundër mungesës së hapësirës</i>	Dhjetor 2018

	<i>brenda arkivave të dosjeve dhe të ndërmarr hapat e nevojshëm drejt përmbushjes së obligimeve që dalin nga neni 5, paragrafi 3 i Rregullorës për ruajtje dhe qasjen në dokumentacionin zyrtar.</i>		<i>dhe personelit do të identifikojë pikat prioritare dhe do të krijojë kushte dhe procedura më të mira për të rregulluar këtë çështje.</i>	
--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--

Shtojcat

Shtojca 1. Të dhëna mbi nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar				
Nr.	Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2015) Inspektimi: Menaxhimi i hetimit dhe zbulimit të krimit, si dhe administrimit të rasteve, nr. 05/2015			Niveli i zbatimit po/jo
	Rekomandimi i dhënë	Komentet e strukturës policore	Afatet për zbatim	
1.	<i>IPK rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të krijojë një grup të ekspertëve të cilët do të analizojnë çështjen e drejtorive mbështetëse në nivelin qendror në mënyrë që të bëjnë një ristrukturim më të mirëfilltë i cili do të krijonte mbarëvajtje dhe lehtësim në kryerjen e detyrave të përditshme hetimore.</i>	<i>Me datë 05.05.2015 Drejtori i Përgjithshëm z. Shpend Maxhuni ka mbajtur një takim me stafin menaxherial për të diskutuar rreth çështjes së listës së autorizuar të Personelit për të marre rekomandimet nga stafi lidhur me draftin e propozuar në këtë mbledhje(Takim ky i cili ka pasuar me nënshkrimin e listës së autorizuar të aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm me datë 07.05.2015. Vlen të ceket se në këtë takim dhe takimet tjera Drejtori ka kërkuar nga Drejtorët e Departamenteve që të fillojnë me analizimin dhe identifikimin e nevojave për plotësim ndryshim të Strukturës Organizative andaj ka kërkuar që secili Departament të këtë analize të tilla dhe pastaj të formohet një grup punues i cili do të hartoj draftin për ristrukturim të njësiteve dhe Drejtorive . JEMI NE FAZËN E PËRGATITJES SE PROPOZIMEVE të cilat do të dërgohen tek Drejtori i Përgjithshëm i cili do të formoj grupin punues për analizimin e propozimeve dhe Draftimin e draftit final</i>		Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Nuk është realizuar</i>
2.	<i>IPK rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të sigurohet se është intensifikuar bashkëpunimi në mes Departamentit për Hetime dhe Departamentit për Burime</i>	<i>Ne takimin javor të rregullt të mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm i PK-së me stafin menaxherial të datës 17.08.2015 Drejtori i PK-së ka kërkuar nga Drejtori i</i>		Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht</i>

	<i>Njerëzore me qëllim të shqyrtimit dhe gjetjes së mënyrave përmes së cilave do të sigurohen se përmbushja e personelit bëhet ashtu siç e ka paraparë struktura organizative si dhe të mos ketë shkëputje (hapësira) në nivelin e respektimit të hierarkisë së gradave.</i>	<i>Departamentit për Burimeve që te përgatisin listat e zyrtareve të cilët për shkak të ndryshimit të emërimit të njësisë apo sektorit të dhënat nuk përputhen me emërtime duhet të sistemohen sipas emërtimeve të reja konform strukturës organizative dhe Listës së autorizuar të personelit. Departamenti për Burime Njerëzore përkatësisht Kol. Taibe Canolli me datë 18.08.2015 ka shpërndarë një shkresë me të cilën kërkohet që te rekomandojnë dhe te propozojnë sistemin e stafit sipas emërtimeve të Drejtorit/ Njësiteve bazuar në strukturën aktuale në fuqi. JEMI NE PROCES TE PERGADITJES SE PROPOZIMEVE.</i>		
3.	<i>IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës që konform strukturës organizative të risistemojnë njësinë e dhunës në familje dhe delikucencë me të mitur e cila njësi do të ketë dhe do të menaxhojë çështjen e të dhënave të përgjithshme të rasteve të ndryshme penale që trajtohen si rezultat i dhunës në familje.</i>	<i>Është risistemuar, bazuar në listën e autorizuar të personelit datë 07.05.2015 është aprovuar dhe nënshkruar Struktura Organizative nga Drejtori i Përgjithshëm i PK-së datë 01.06.2015 andaj konsiderojmë se rekomandimi është i përfunduar.</i>		Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Ky rekomandim gjatë kësaj faze inspektuese nuk është vlerësuar</i>
4.	<i>IPK rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të angazhohet në krijimin e një grupi nga të tri nivelet hetimore të cilët do të punonin në përpilimin e një dokumenti (formulari) që do të përfshinte në vete veprimet hetimore të autorizuara fillestare të policisë me qëllim që më pastaj të kenë pasqyrim më të qartë në procesin procedural si mënyrë që do të lehtësonte angazhimet nga ana e hetuesve.</i>	<i>Është formuar Grupi punues në nivel qendror i cili grup është në kontakt të vazhdueshëm me nivelin lokal duke shpërndarë materialin dhe duke pranuar rekomandime nga niveli lokal, grup ky i cili është duke punuar me ekspertet ndërkombëtar të BE-së të angazhuar nga Projekti i Binjakëzimit” Fuqizimi i kapaciteteve në parandalimin dhe luftimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit” Drafti i Parë është përgatitur dhe pritet te</i>		Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Nuk është realizuar</i>

		<i>finalizohet ne muajin Tetor 2015</i>		
5.	<i>IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës të sigurohet që në rrethanat kur hetimet ndërtojnë ‘dyshimin e arsyeshëm’ se është kryer një vepër penale brenda njëzetë e katër orëve (24) të respektojnë dispozitën ligjore nga KPPK, për të dorëzuar raportin policor prokurorit të shtetit që është kompetent.</i>	<i>Ju është shpërndarë rekomandimi zyrtarëve përgjegjës për hetime ne gjithë policinë e Kosovës dhe pritet implementimi praktik i këtij rekomandimi.</i>		Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht</i>
6.	<i>IPK rekomandon menaxhmentin e lartë kompetent që të rishikojë dhe plotësojë PSO- në (/ZDPO/02/023/2013) për Kompetencë Lëndore në mënyrë sa më të detajuar të mundshme duke përcaktuar specifikat-rrethanat kur një vepër penale mund të hetohet në të tri nivelet.</i>	<i>Zëvendës Drejtori i përgjithshëm i PK-së z. Naim Rexha ka potencuar disa herë në takime se duhet të rishikohet kjo Procedurë dhe ka dhënë sugjerime që të bëjmë një analizë te ndryshimit të ligjeve e cila reflekton në këtë PSO,e pastaj te formoj grupin i cili do të filloj me draftimin e dokumentit të plotësuar.</i>		Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Nuk është realizuar</i>
7.	<i>IPK rekomandon menaxhmentin e lartë kompetent të secilit nivel hetimor të sigurohen që hetuesit të jenë më të kujdesshëm dhe azhur në kthimin e informatave tek DIA, në mënyrë që kjo drejtori të përmbushë detyrimet e saj duke pasur pasqyrim dhe shpërndarje më të mirëfilltë të informacionit dhe analizës tek të gjitha njësitë.</i>	<i>Lidhur me këtë rekomandim janë përpiluar disa dokumente “ Strategjia Policimi i Udhëhequr nga Inteligenca” PSO-ja “Detyrat e zyrtarëve Policor në Procesin e Inteligjencës, Dokumenti, është realizuar dhe shpërndare fletushka për te informuar zyrtaret policor për rëndësinë e përpilimit të informatave Inteligjente, Zyrtarëve policor i janë shpërndarë kartela informuese me nocionet themelore dhe rendësin e Inteligjencës, Është funksionalizuar sistemi i ri i SIPK-ut, i cili mundëson dhe lehtëson dhënien e Informatave kthyesë, e cila me rastin e zbatimit të të lartcekurave konsiderojmë se do te jepen rezultate konkrete ne dhënien e Informatave kthyesë.</i>		Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht</i>

8.	<p><i>IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës hetimor të angazhohen në krijimin e një standardizimi të mënyrës së menaxhimit të dosjeve hetimore duke parashtruar kërkesa me specifika për tu furnizuar me folder përmbajtësor për fushën hetimore me qëllim të ruajtjes së mirëfilltë të dosjeve.</i></p>	<p><i>Grupi punues i cili është përshkruar rubrikën e komentit të rekomandimit Nr. 4 të këtij dokumenti ju ka dhënë detyre që me rastin e draftimit dhe finalizimit të Udhëzuesit të përshkruaj një kapitull të veçantë (Drafti është i përgatitur) i cili ka të bëjë me standardizimi të mënyrës së menaxhimit të dosjeve hetimore duke parashtruar kërkesa me specifika për tu furnizuar me folder përmbajtësor për fushën hetimore me qëllim të ruajtjes së mirëfilltë të dosjeve.</i></p>		<p>Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht</i></p>
9.	<p><i>IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës që të sigurohen se të gjitha arkivat e dosjeve hetimore të jenë të pajisura me libra zyrtarë të evidentimit të cilat do të duhej të plotësoheshin në përputhje me specifikat që i parasheh.</i></p>	<p><i>Menaxhmenti i Departamentit të Hetimeve ka marrë për obligim që të zbatoj këtë rekomandim duke bërë porosinë e regjistrave të cilët do të jenë unik në të gjitha dhomat e dosjeve, Ky rekomandim do të plotësohet deri në fund të vitit 2015</i></p>		<p>Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht</i></p>
10.	<p><i>IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës që të merr masa për zbatimin e PSO-së për arkiva dhe ruajtjen e dosjeve si dhe të krijojë kushtet e nevojshme për arkivim duke filluar nga hapësira (ambienti) për arkivë, raftet e domosdoshme dhe pajisjet tjera përcjellëse për sigurim, ndriçim dhe ajrosje.</i></p>	<p><i>Pasi të jetë i aprovuar Udhëzuesi për të cilin janë duke punuar grupi punues me ekspertet e BE-së në kuadër të Projektit të bijankëzimit (Konsiderojmë në Tetor 2015 të aprovet dhe hyn në fuqi Udhëzuesi i Përbashkët me Prokurorinë e Shtetit) Do të ndërmerren masat adekuate për të porositur materialin e nevojshëm konform këtij Udhëzuesi, si dhe përpilimin e PSO-së konform këtij Dokumenti.</i></p>		<p>Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht</i></p>